



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1975/1 Prot.

Pogradec, më 10 . 05 2021

VENDIM

Nr. 44, DATË 06.05.2021

**"PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.37 DATË 16.04.2021 "PËR DHËNIE
NDIHMË FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z. BESNIK FAIK MIMINLLARI PËR
SHKAK TË RËNIES SË ZJARRIT NË BAZËN USHQIMORE BLEKTORALE"**

Në mbështetje të; nenit 8, nenit 40, shkronjës "dh" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", nenit 6 të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pikës 132 të Udhezimit nr.9, datë 20.03.2018 "Per Procedurat Standarte te Zbatimit te Buxhetit", si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 144, datë 24.12.2020, "Per miratimin dhe detajimin e buxhetit te Bashkise Pogradec për vitin 2021", pas shqyrtimit të dokumentacionit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Të miratojë, dhënien e ndihmës financiare për familjen me kryefamiljar z. Besnik Faik MIMINLLARI, banues në fshatin Blacë, Njësia Administrative Çërravë, Bashkia Pogradec, në masën 500 000 (Pesëqind mijë) lekë, për përballimin e dëmeve të konsiderueshme të shkaktuara nga zjarri i rënë në pronën e tij, më datë 20.03.2021, dëmi nga ana ndërtimore për diegien e magazinës, materialeve dhe bazës ushqimore të ndodhura në të dhe dëmi nga ana e "Gjësë së Gjallë" për diegien e kafshëve dhe blegtorisë.
2. Kjo shumë do të përballohet nga fondi rezervë i parashikuar në Buxheti i Bashkisë Pogradec për vitin 2021.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas lajmërimit nga zyra përkatëse.

KRYETARI I KËSHILLIT
Sotiraq MANGËRI

